




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	17.10.2018	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
08-320/01-341	26	12	



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Komuna Kaçanik

Opština Kaçanik

Municipality Kaçanik

VENDIM

Në kuadër të projektit **“Të rinjtë në Agrobiznes- Regjioni Ekonomik Lindor,”** projekt i financuar nga Bashkimi Evropian, menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe realizuar nga Komuna e Gjilanit është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit për bashkëpunim në mes të Komunës së Kaçanikut dhe Komunës së Gjilanit.

Pas konsultimit me Drejtorinë e Bujqësisë është vendosur që personi kontaktues për Komunën e Kaçanikut të caktohet

z./znj. Fatmir Loku

tel .044 227 989

e-mail.fatmir.loku@rks-gov.net

Ky vendim vlen gjatë realizimit të projektit dhe në rast të revokimit të njëjtit.

Data: 16 Tetor 2018

z. Besim Ilazi

Kryetar i Komunës së Kaçanikut





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Kryetari i komunës
01-Nr. 104/02-35514/18
Kaçanik, më 30.11.2018

Në mbështetje të neneve 13. Dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 02/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 të datës 4 Qershor 2008, komfor nenit 73 të Statutit të komunës të datës 25.09.2008 për përgjegjësitë e Kryetarit, nenit 20 të Ligjit të nr. 06/021 për Kontrollin e Brendshëm të financave publike, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit administrativ Nr.11/2010 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Sektorin Publik, Kryetari i komunës merr këtë:

VENDIM

Për riemërimin e anëtarit të Komitetit të Auditimit

1. Nora Rakës i vazhdohet mandati në pozitën e anëtarit të Komitetit të Auditimit.
2. Riemërimi i të përmendurës nga pika e I-rë të këtij vendimi, bëhet edhe për një mandat dy vjeçar, anëtare e dyte e komitetit të auditimit të komunës së Kaçanikut.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të Kryetarit të Komunës.

Kryetari i komunës
Besim Ilazi



Me këtë vendim njoftohen:


- Nora Raka, Kryetari i komunës, NJAB dhe Komiteti i auditimit



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipality of Kaçanik

01Nr. 106/02-38375/18

Në bazë të nenit 13.3 të Ligjit Nr.05/L125 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nenit 4 paragrafi 4.1 dhe 4.2, nenit 7 në harmoni të plot me nenin 8 pika 5, 7, 9 dhe nenit 19 të rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, në mbështetje të fermerëve, Kryetari i Komunës me rekomandimin e komisionit për vlerësim të kërkesave nxjerr këtë:

VENDIM

Për mbështetje të fermerëve me mjete financiare për makina mjelëse

I

Me këtë Vendim lejohet ndarja e mjeteve në shumë prej 9,760.00€, fermerëve përfitues të projektit (61), për blerje të pajisjes (makinë mjelëse), me qëllim të realizimit të projektit “Mbështetje të fermerëve me makina mjelëse”.

II

Shuma e mjeteve e paraparë për fermerët përfitues do të transferohet secilit fermerë në llogarinë rrjedhëse bankare, në bazë të marrëveshjes individuale, ofrimit të dëshmisë së fermerit (faturën e blerjes) dhe verifikimit nga komisioni komunal për posedimin- blerjen e makinës mjelëse.

III

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores për kushtet, kriteret, dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve për fermerë.
2. Mbështetja financiare publike për projektet /programet e drejtorisë do të ofrohet nga Buxheti i Komunës, kodi ekonomik 22000 në kuadër të programit subvencione dhe transfere me buxhetin e ndarë për vitin 2018

IV.

1. Mjetet e përmendura në nenin I do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

V.

2. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është: Drejtoria e Financave, Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

VI.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi

